




**AIDA**

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

TETOR - DHJETOR 2020

Revista e AIDA-s, newsletter, është botim i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

AIDA me anë të këtij botimi synon të informojë në mënyrë të vazhdueshme bizneset, palët e interesit dhe publikun për veprimtarinë e agjencisë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) publikon revistën periodike Newsletter për periudhën tetor-dhjetor 2020.

Në Newsletter do të gjeni të gjitha informacionet e përmbledhura për tremujorin e fundit të vitit 2020 rreth aktivitetit të agjencisë, takimet e organizuara, webinarët e zhvilluara, trajnimet online, vizitat, forumet si dhe rubrikat e publikuara në faqen web, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen etj.

AIDA, ka vazhduar të jetë proaktive, mbështetëse dhe në dispozicion me të gjitha shërbimet dedikuar bizneseve dhe palëve të interesit, çdo veprimtari dhe nismë që ka ndërmarrë në këtë periudhë pandemie ka qenë në përputhje me zbatimin e rregullave të vendosura nga Qeveria Shqiptare në situatën e COVID-19.

'E Dua Shqip' është fushata më e re promovuese e ndërmarrë nga AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve 'Made in Albania'. Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë e gjithëpërfshirës.

Gjithashtu, në faqen web vazhdon të përditësohet rubrika "COVID-19", e cila ka si qëllim qasjen në informacion më të fundit dhe qarkullimin e tij në një kohë sa më të shpejtë për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u informuar mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve na vizitoni, në:


 @aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  @investinalbania



SHESHO KURBËN!

RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju kujton që duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm dhe të respektojmë masat parandaluese kundër COVID-19. Sot më shumë se çdo ditë ka nevojë për solidaritet.



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al
tel: +355 042 251 001
web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e investitorit strategjik, bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare.

Dokumentet e çfarëdollojshme përcillen përmes Postës Shqiptare, nëpërmjet adresës zyrtare të AIDA-s, info@aida.gov.al ose pranë zyrave të AIDA-s duke u lidhur më parë me stafin tonë.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale për përditësime.

AIDA Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

AIDA shërben si një nyje lidhëse mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Qëllimi i saj është të ndër marrë nisma të vazhdueshme që gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, biznese të zhvilluara, mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja në përputhje me profilin e burimeve dhe aspiratat e Shqipërisë.

AIDA është promotore e markës “Made in Albania”.

Në misionin e vet, vijon të mbështesë bizneset vendase duke zhvilluar sidomos sektorët prioritarë.

Gjatë vitit 2020 AIDA ka dhënë mbështetje konkrete ndaj biznesit vendas, ka ndikuar në thjeshëtimin e procedurave për investitorët e huaj, vendosjen e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përcimin e informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimin e disa “outreach campaign” në sektorët potencialë, realizimin e disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t’u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shënjon një strategji novatore, një vizion të ri në mënyrën e qasjes dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të Shqipërisë.



FUSHATA MË E RE NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE ‘MADE IN ALBANIA’

AIDA, shërben si një pikë qendrore për sipërmarrjet dhe është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale.

E Dua Shqip është fushata më e re promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’.

Qëllimi ynë është që të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera.

Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni një përshkrim dhe një foto të produktit.

Rrënjët janë të rëndësishme.

Kjo nismë kërkon bashkëpunim, besim dhe interes, prandaj nëse interesoheni të jeni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

VIP TIE

zgjdh të vendit

Kravata 3D

Sallon i parë i modës në Tiranë, Onus Maison filloj rregullimin e tij në vitin 1927 për hattimin dhe krijimin e veshjeve të modës së lartë duke përdorur pëlhurat më të mira që do ti rezistonin kohës. Marka prestigjioze Onus, sot e shoqëruar me inovacionin sjell prezantimin e kravatave të famshme 3D. Mënyra e pafund për t'u shprehur përmes një koleksioni unik plotësisht të personalizuar të punës së dorës dhe printimeve 3D.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Onus Maison: viptie@3b-army.com ose në 0674017017.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zgjdh të vendit

Kostum Popullor i Beratit

Zakonet dhe traditat e jetes shqiptarë janë trashëguar të pasqyruara në krijimtarinë popullore. Kostumi tradicional i Beratit, i qëndisur me fije ari, i punuar me gjilpër me dorë të lirë, mund të cilësohet pa frikë si një kryevepër, vlera e të cilit rritet sa më shumë që kalon kalon.

Në qytetin e Beratit, qëndistari Albana, sipas porosisve sjell në treg këtë produkt të veçantë dhe original, tërësisht punim dore.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Qëndistari Berat: albana.ball@hotmial.com ose në 0694588313.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zgjdh të vendit

Vaj Ulliri 'Subashi'

Në Mal-Subash, në zonën e Marikaj, gjenden ullinjë qindërveçare kalinjot, të pasur me vlera ushqimore.

Familja Subashi me traditën e vjetër të mbledhjes dhe përpunimit të ullirit, përgatit vajin e ullirit ekstra të virgjër 'Subashi', unik për shijen dhe aromën e tij të mrekullueshme.

Vajin e ullirit ekstra të virgjër 'Subashi' mund ta gjeni në Kalanë e Tiranës, ose ta kontaktoni në numrin 0684094211 dhe në adresën e email: silvana_pinari@yahoo.com.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zgjdh të vendit

Mjaltë Gështenje

Në zonën e Korçës, bletët mes luleve të gështenjës, mbledhin nektarin e ëmbël për mjaltin e shijshëm dhe kurues të gështenjes.

Ngjyra e tij e veçantë, e errët dhe aroma e drunjtë, i jpin mjaltit një shije të pakrahueshme. Mjalti i gështenjës 'Morava' është një burim i shkëlqyer i proteinave dhe mineraleve.

Mjaltin 'Morava' mund ta porosisni në numrin e telefonit 0692055580 ose në adresën e email info@mjalte-morava.com.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zgjdh të vendit

Trahana "Lunxheria"

Tani është verë, por në verë përgatiten zahiret e dimrit. Me diellin e nxehtë të verës i bëjmë gati që ato të jetojnë gjatë.

Në krahinën e Lunxhërisë, duke ruajtur traditën lunxhiote përgatitet me dashuri trahania e thartë, një ushqim shumë i shëndetshëm. Kompania Lunxhëria sigurohet që të sjell cilësinë më të mirë në treg, duke mos humbur shijen unike të prodhimeve vendase.

Zgjdh tënden, kontakto me kompaninë Lunxhëria në: trahanalunxheria@gmail.com ose në 0693590672.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zgjdh të vendit

Gjalpë Lajthie

Gjalpi i lajthisë ka sasi të larta vitaminë E, B1 dhe B6, magneziumi dhe fosfori. Lajthia gjithashtu ka sasi të larta antioksidantësh që ndodhen kryesisht në lëkurën e lajthive.

Kompania "Pemla" ofron 100% produkt vendas dhe të sigurt në përdorim. Është i këshillueshëm për personat me kolesterol të lartë në gjak dhe inflamacion.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Pemla: info@pemla.al ose në 0692925333.



Vera Saze

Vera Saze merr frymëzimin e saj nga Ansambli Saze, muzika e të cilët buron nga një instrument i lashtë tradicional në zonën e Përmetit - ashtu si dikur Debina e Bardhë për të bërë këtë verë.

Debina e Bardhe, një larmi autoktone në Shqipërinë Jugore dhe veçanërisht e rritur në Përmet, është korrur me dorë nga vendasit në një lartësi prej 250 metra përgjatë lumit Vjosa.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Wine Society: wine.society.al@gmail.com ose në 0683030005.



Sapun Artizanal

Në fshatin Shtoji, në Shkodër prodhohet sapuni natyral artizanal me vajra dhe bimë nga vendi ynë. Ky produkt është 100% natyral, pa përbajtur kimikatesh dhe si rrjedhojë është miqësor me mjedisin.

Sapuni natyral artizanal njihet për vetitë e tij për një lëkurë të pastër dhe të shëndetshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Natyra ime: info@natyraime.al ose në 0672860849.



Bleta Shafraan

Në Petrelë shumë pak minuta larg Tiranës që prej 3 vitech në një fermë të vogël kultivohet bima e mrekullive, bima e shafraanit. Shafraani prodhohet në kushte tërësisht organike me një cilësi të lartë dhe është një thesar i vërtetë për organizmin tonë pasi ndihmon në forcimin e kujtesës, të zemrës dhe qetëson sistemin nervor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Bleta Shafraan: blo-tashafran@gmail.com ose në 0692065921.



Gliko rrusi "Bonjo"

Tradita përmetare e përgatitjes së glikove vazhdon të ruhet me një kujdes të veçantë që nga viti 1995, nga punishtja Bonjo, e cila me eksperiencën e gjatë dhe cilësinë që ofron sjell glikonë e mrekullueshme të rushtit. Glikoja përpunohet nga fruta tërësisht bio, që mbledhen në zonën e Përmetit dhe përgatitet në mënyrë artizanale sipas recetave të gatimit të amvisave Përmetare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Gliko Bonjo: altinbonjo@gmail.com ose në 0693340088; 0693211074.



Lëng Frutash "Eliksir"

Në çdo cep të Shqipërisë fermerët punojnë me dashuri tokën për të gëzuar pastaj prodhimin e tyre në tryezat e secilit. Kompania Kop Frut Dibër 2012, nisi rrugëtimin e saj për të bërë bashkë frutat e fermerëve dibranë.

Ajo prodhon lëngjet e frutave 100% bio. "Eliksir". Karakteristikë e këtyre produkteve është përbajtja e tyre pa konservant, pa sheqer, pa ujë dhe pa asnjë element tjetër të shtuar.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kop Frut Dibër 2012: kop.frut@gmail.com ose në 0693440444.



Gliko "Përmeti"

E kush nuk i njeh glikotë e Përmetit? Glikotë e domateve jeshile dhe patëllkhanit me arra. Kompania gliko "Përmeti" ndjek traditat e trashëguara ndër vite për të sjellë një nga produktet më specifike, glikonë e arrës.

Kjo gliko dallon për formën e bukur, shurupin e trashë dhe shijen e jashtëzakonshme. Ajo është një nga glikotë më kurative dhe me më shumë kohëzgjatje.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën, pruvoni Gliko "Përmeti": krenaurrice@yahoo.com ose në 0695152856.



zojdh
të vendit

Qumësht gomarice

Qumështi i gomaricës është rekomanduar që në antikitet për të luftuar sëmundje si alergjitë, astma dhe ekzema. Ky qumësht i rrallë por me veti të larta ushqimore silltet nga Ferma Zoe, në Papër të Elbasanit. Kjo fermë kujdeset për rritjen e gomaricave, mbledhjen dhe përpunimin e qumështit. Ngjyra e ndritshme, niveli i ulët i yndyrës dhe vitaminat e shumta, e kanë kthyer qumështin e gomaricës në një ilaç jetësor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@fermazoe.al ose në 068 326 6400.



zojdh
të vendit

Çaji i Hithrave

Çaji i Hithrave vjen nga barërat e zgjedhur dhe tharë me metoda tradicionale, duke ruajtur të gjitha cilësitë e tij dhe duke garantuar një produkt të pasur dhe të shijshëm. "Northern Herbalist" siguron cilësinë më të mirë të bimëve nga klima mesdhetare malore e territorit të Pukës.

Çaji i Hithrave të Herbalistëve të Veriut është 100% natyral dhe thuhet se është një pije e fortë detoksuese dhe energjike.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: enklajdzeneli@gmail.com ose në 069 45 68 919.



zojdh
të vendit

Veshje të qëndisura

Nëse doni të keni veshje të qëndisura dhe të personalizuar sipas dëshirës suaj, studio qëndistarie "Memory Craft" ju vjen në ndihmë. Personalizimi mbështetet në folklor, traditë, trashëgiminë muzikore, shprehje popullore, shprehje dialektore, promovimi i fshatrave, qyteteve, elementeve heroik të luftërave, dhe sjellja e tyre në kontekst modern. Qëllimi i studios është rikthimi i artizanatit në një version të 2020, duke u mbështetur në trashëgiminë shpirtërore kryesive të veriut të Shqipërisë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën, në "Memory Craft": marku.djana@yahoo.com ose në 069 45 64 402.



zojdh
të vendit

Vera "E kuqja e Beratit"

E kuqja e Beratit, frut i rrusht vendas shqiptar, të quajtur Vlosh, e vjetëruar në fuçi lisi me karakteristikat e saj origjinale në ngjyrë, aromë dhe shije, cilësohet si vera "Më e mirë e të mirave" në kantinën Çobo.

Pikturat e magjishme të Onufrit dhe sidomos e kuqja e tij e paarrtshme kanë qenë një frymëzim në prodhimin e kësaj vere.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kantina Çobo: info@cobowineryonline.com ose në 067 407 0562.



zojdh
të vendit

Ora Artizanale

Prodhuesi i drurit të bredhit, i riu Franci Shllaku prej vitesh ushtron artin e bukur të gdhendjes. Nga druri i bredhit Franci bën ora të madhësive të ndryshme.

Orat e bredhit janë të ndërtuara me një mekanizëm të thjeshtë dhe të pasuruar me detaje origjinale dhe moderne. Orat e bredhit janë të përshtatshme për ambiente të jashtme dhe të brendshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën, Handmade F.Sh: shllakufranci@gmail.com ose në 0692909339.



zojdh
të vendit

Vera "Kashmer"

Vera Kashmer, një kombinim i tre llojeve të rrushtit: Kabernet, Shesh dhe Merlot vjen në treg si një markë e re e frymës krijuese të verës Çobo. Kashmer është një verë harmonike e butë dhe rubin, vlerësuar nga dashamirësit më të kërkuar të verës. Rrushi, nga i cili prodhohet vera "Kashmer", mbledhet nga vreshtat e kultivuara në zonën kodrinore të Beratit, 200-500 metra mbi nivelin e detit. Kjo verë është një specialitet familjar dhe është një nga dy verërat e nënshkuara që prodhohet dhe shitet ekskluzivisht nga kantina Çobo.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kantina Çobo: info@cobowineryonline.com ose në 067 407 0562.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Vera "Shesh i Bardhë"

Vera aromatike dhe autoktone "Shesh i bardhë" e fshatit Naraç, prodhohet në mënyrë artizanale sipas varieteteve të rushit të prodhuara në vreshtat e familjes. Kantina e verës "Ersi" ruan traditën qindra vjeçare të zonës së Zadrimës dhe është në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Kjo verë me aromë delikate, intensive dhe me cilësi të lartë, shfaqëron antipastat, mishrat e bardhë dhe peshkun.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në kantinën "Ersi": jakpacani@yahoo.com ose në 068 206 7637.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Mjaltë shumëlulësh

Në jug të Shqipërisë, në zonën e Labërisë, kompania "Mjaltë Shametaj" prodhon mjaltin shumëlulësh. I njohur gjerësisht në mjekësi ndihmon në sëmundjet e organeve të tretjes, artritin reumatik, sistemin imunitar dhe atë nervor duke e bërë të vetmin produkt që përmban 16 aminoacide. Përbërësit antibakterial dhe antifungal që gjenden tek mjalti shumëlulësh bën që të përdoret dhe si antiseptik natyral ku bakteret nuk mund të rrinë më tepër se dy orë tek mjalti i maturuar.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në "Mjaltë Shametaj": bletariashametaj@gmail.com ose në 069 47 30 481



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Vera "Pulsi i Beratit"

Varieteti i rushit autokton Puls sjell këtë verë me ngjyrë të artë të lehtë, aromantike me strukturë potente, tipike dhe elegante.

Rushi shekullorë dhe vera e prodhuar prej tij qëndron si xhevahir në kurorën e qytetit të lashtë të Beratit, prodhuar nga kantina Nurellari. Kjo verë ka marrë vlerësimin e saj edhe në ballkan, ku kompania Nurellari është vlerësuar me medalje argjendi për verën Pulsi Beratit 2015.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kantina Nurellari: fatosnurellari@yahoo.com ose në 069 76 94 770.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Vera Merlot Rezervë

Nga vreshtat më të mirë në kodrat rreth zonës së Durrësit, është përzgjedhur mush i pasur për prodhimin e Merlotit Rezervë.

Kjo verë është rezultat i një përzgjedhje të rushit Merlot me përqëndrim të jashtzakonshëm dhe cilësi tepër të lartë nga "Kantina Alimani". Vera Merlot Rezervë vjen me aromë karakteristike vjetërimi duke sjellë një verë me ngjyrë rubini.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në "Kantina Alimani": info@alimaniwinery.com ose në 069 222 6066.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Raki "Selenica"

Në zonën e fshatit Trevllazër, në Vlorë, vilet rushi nga vreshtat me ekspozimin më të mirë në diell dhe në lartësi jo shumë të mëdha. Raki "Selenica" ka një ëmbëlsi të pjekantë, pasi përdoret rushi i pjekur mirë dhe me aromë.

Shija e rakisë lihet të maturohet në fuçi druri e më pas vulozet në shishe qelqi, ku fillon procesin e vjetërsisë së saj, duke e kthyer në një raki të pashoqe.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kristoselenica@gmail.com ose 0682076666.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Gliko shalqini

Në Përmet, që nga viti 1992 është themeluar punishtja artizanale Almeg. Punishtja Almeg përpunon frutat të cilat rriten në vendin tonë. Në foto gjeni të ekspozuar glikonë e shijshme të shalqinit, karakteristike për vendin tonë.

Glikoja e shalqinit është e një cilësie të lartë pasi përgatitet nga një staf me një eksperiencë të gjatë në teknologjinë e ushqimit.

E duam shqip dhe zgjedhim për t'u ëmbëlsuar glikonë Almeg: aldonasi@yahoo.com ose në 0696203442 / 0694286154.



Vera "Kallmet"

Kantina Arbëri e nisi aktivitetin e saj në vitin 2003, në zonat më të vjetra të Mirditës. E vendosur në një zonë të mirënjohur, vreshtat e Bukmirës, Prosekut dhe Kodër Rrëshenit kanë një sipërfaqe rreth 100 ha, në të cilat 60 % është Kallmet dhe 40 % varietete të ndryshme.

Vera "Kallmet" ka një ngjyrë të kuqe që spikat, aromën e mollës së kuqe të pjekur mirë si dhe aromën e boronicës.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në:
info@kantina-arberi.com ose 069 20 57 553.



Lahuta e Bjeshkëve

Në zonën e Pukës, tingulli i Bjeshkëve fshihet në lahutave të skalitura prej druri të bredhit të njomë. I rritur në një zonë tërësisht malore Vitor Shahini është përpunuesi më i njohur i drurit, i kësaj krahine. Prej vitesh ai është kushtuar këtij zanati të bukur me qëllimin mbajtjen gjallë të traditës shekullore të lahutave prej druri, të punuara me pasion. Çdo notë që luhet në këto lahuta mbart kujtime të historisë pukjane.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në:
druartpuka@outlook.com ose 069 515 1368.



Vaj Ulliri "Musai"

Fabrika Musai Olive Oil, e pozicionuar përballë kodrave të ullinive shekullore të varietetit kalinjtë në rrethin e Vlorës, sjell që prej vitit 1995 një produkt cilësor për konsumatorin. Vaji i ullirit Musai konkuron denjësisht në tregun vendas dhe të huaj si produkt i certifikuar bio/organik nga institucionet ndërkombëtare, duke eksportuar në tre kontinentet të ndryshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Musai Olive Oil:
info@musaioliveoil.com ose në 0692619605.



Kostume Popullore "Joni"

Dëshira për trashëgiminë e kulturës bëri që artizanet Vjollca Tahiri, në Bërdicë të Mesme, Shkodër të sjell krijimin e kostumeve tradicionale të disa krahinave të Shqipërisë, nën emrin "Kostume Popullore Joni".

Punimet për shitje janë të gjitha të punuara me dorë. Por për të gjithë ata që duan të kenë të paktën një kujtim me këto veshje "Kostume popullore Joni" ofron gjithashtu mundësinë e marrjes së tyre me qera.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në "Kostume Popullore Joni":
vjollcatahiri2@gmail.com ose në 0672870379.



Ullinj nga "NenaFarm"

Nena Farm SHPK është një sipërmarrje që ka në fokus prodhimin e produkteve premium, vaj ulliri dhe ullinj tavoline. Ullinj të NenaFarm vijnë nga ullishte shekullore të varietetit autokton "Kalinjtë", të cilat gjenden në fshatin Lukovë, (Sarandë) përballë detit Jon.

Ullinj të vilen me dorë dhe përpunohen brenda 12 orësh, duke garantuar në këtë mënyrë që produktet të ruajnë aromën e tyre natyrale dhe vlerat ushqyese.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në NenaFarm:
info@nenafarm.com ose 069 89 67 533



Lëng Sheqe

Shega renditet në listën e frutave që kanë të njëjtat vlera si në formën e plotë ashtu edhe në formën e lëngut.

Kompania Agrolliria që prej vitit 2014 kujdeset për kultivimin e këtij fruti në vendin tonë, për ta sjellë më pas në formën e lëngut të frutave.

Vlerat e lëngut të shegës janë të pamohueshme duke u cilësuar si një burim i pashtershëm vitaminash dhe mineralësh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Agrolliria Group:
info@agrolliriagroup.com ose në 0692052616.



Veshje Tradicionale

Butik atelie "Kozeta" përcjell vlerat tradicionale dhe kulturore të vendit, nëpërmjet prodhimit të veshjeve tradicionale. Ka filluar aktivitetin e saj në qytetin e Vlorës, në vitin 2010, me prodhim të veshjeve të ndryshme. Gjithashtu, nga viti 2017, ofron për të interesuarit në qytetin e Tiranës riprodhim të kostumeve popullore shqiptare dhe veshje moderne të ndërthura me tradicionale. Butik atelie "Kozeta" sigurohet që çdo element tradicional të jetë punim artizanal.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në:
kozetalicohallit@gmail.com
ose 069 27 00 589



Enë prej balte

Në një botë plastike dhe me zhurmë, enët dekorues prej balte janë një burim krijimi dhe frymëzimi. Stili i pastër prej kombinimit të ngjyrave, motiveve florale, linjave dhe formave gjeometrike, bën që këto produkte të përdoren në ambiente të ndryshme të shtëpisë apo zyrave. Ato punohen në qytetin e Elbasanit me argjilë e cila thahet dhe ngurtësohet në ajër dhe kalon në disa procese si: lëtimi, shkëlqimi, dekorimi dhe aplikimi i ngjyrave në dizajne të ndryshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në:
eneida.firaku@yahoo.com
ose në 069 544 6971.



Çaj Goliku

Çaj i golikut është përzierje e gjashtë lloje çajrash në një të vetëm. Ky çaj, miks i frutave të egra të mbledhura me kujdes në Malet e Shqipërisë, kryesisht në Malin e Golikut, në zonën e Përmetit, përmban: kullamari, boronicë e zezë, mollë e egër, trëndafil i egër, dëllenjë e zezë dhe fruta murri.

Kompania BUMI kujdeset që të ofroj një produkt 100 % të pastër dhe të përgjeshur me kujdes.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën: info@bumi.al
ose në 069 251 0468.



Vorba nga Gojani i Pukës

Familja Biba nga Gojani i Pukës, është e vetmja familje në Shqipëri që prodhon Vorba prej balte me të njëjtin teknikë të vjetër sa vetë njerëzimi. Ajo çfarë i bën autentike këto Vorba, është materiali i veçantë që përdoret për prodhimin e tyre, të cilin prodhuesit e quajnë "botë". Duke e bërë historinë më të prekshme, kjo familje sjell një produkt unik për gatimet tradicionale, duke ruajtur traditën e vjetër të prodhimit me balte të enëve të gatimit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në:
vorbat.gojan@yahoo.com
ose 068 54 79 083



Raki Rrushi e Vjetëruar

Nga distilimi tradicional i mushtit lind raki. Kjo raki vjen nga një kantinë e cila njihet për cilësinë e lartë të prodhimit. Kantina Arbëri e ka nisur aktivitetin e saj në vitin 2003 në një zonë të mirënjohur, vreshtat e Bukmirës, Prosekut dhe Kodër Rrëshenit. Përbërja e varietetit është nga Shesh i Bardhë, Kallmet dhe Shesh i Zi. E veçanta e kësaj rakië është që kalon një stazhionim nga 10-12 muaj në një enë dru lisi përpara vendosjes në shishe.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kantina Arbëri:
info@kantina-arberi.com
ose në 069 20 57 553.



Qëndistari Zyberaj

Veshjet tradicionale janë element të rëndësishëm që identifikojnë edhe kulturat nga njëra-tjetra. Qëndistari Zyberaj, e pozicionuar në veri të Shqipërisë, ka mbledhur së bashku artizanet e Vau Dejës-it për të sjell produktet dhe veshjet tradicionale, por gjithashtu për të mbajtur gjallë një kulturë aq të vjetër sa territoret e këtij vendi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Qëndistari Zyberaj:
qendistari.zyberaj@hotmail.com
ose në 0692804582.



zgjdh të vendit

Sapuni "Bardha e Temalit"

Sapuni "Bardha e Temalit", një produkt 100 % vegan, i prodhuar me ekstraktet më të veçanta të luleve bimore të maleve shqiptare. Kompania ertizanale "Zana e Malit" inspiruar nga bimët tradicionale të maleve është kujdesur t'i shtojë tregut prodhime natyrale që trashëgojnë traditën e përkujdesjes dhe bukurisë Shqiptare.

Sapuni përmban lule kemomili, vaj hudhre, tërshërë, lule kalendula, xhel aloe vera dhe rozmarinë. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Zana e Malit; zanaemalit@zanamalit.al ose në 0672061644.



zgjdh të vendit

Boronica

Në veri të Shqipërisë, në rrethin e Tropojës, në pyjet e larta të pishës e të ahut e deri në kullotat alpine, kompania "LEA-2011 shpk", mbledh për ju bimën e boronicës. Boronica ndihmon trurin dhe zemrën, mbron sytë dhe lëkurën. Antioksidantët që gjenden te boronicat, siçomos ato që rriten të egra në tokat shqiptare, janë aq të forta sa janë të afta për të neutralizuar radikalët e lira që lidhen me zhvillimin e disa sëmundjeve kardiovaskulare apo tumorale.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në kompaninë "Lea-2011 shpk":lea2011shpk@gmail.com ose në 0694782045.



zgjdh të vendit

"Vaj Borshi"

Në Rivierën Shqiptare, në fshatin e bukur të Borshit, në një territor të njohur që në lashtësi për ritjen e ullinjve qindrvjeçarë, kultivohet ulliri Kalinjot.

Kompania "O&B shpk" që prej vitit 2000 sjell në treg markën "Vaj Borshi" duke plotësuar standardet më të larta, që nga grumbullimi i ullinjve, pastrimi i tyre dhe deri tek teknologjia e përpunimit për daljen e një vaji cilësor për konsumatorët.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në kompaninë O&B shpk: vaj.borshi@gmail.com ose në 0692094712.



zgjdh të vendit

Çaj "Albanian Tea"

Albanian Tea, vjen në treg nga një punë e palodhur e njerëzve të cilët dashurojnë natyrën. Mbledhja e luleve dhe gjetheve të ndryshme përgjatë gjithë kodrave, fushave e luginave të Shqipërisë e bën çajin, një produkt të dashur për këdo, me varietete të pasura si çaj mali, kamomili, boronice, sherebel etj.

Direkt nga natyra çaji kalon në procesin e tharjes së lules dhe gjetheve, pastrimit në mënyrë artizanale dhe paketimit të tij, duke sjell një produkt të pastër e plot aromë lulesh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Albanian tea në albaniantea1@gmail.com ose në 0692094712.



zgjdh të vendit

Lëng "Goji Berry"

Goji Berri, fruti që zgjat jetën. Në vite ky frut ka gjetur përdorim në mjekësinë popullore. Falë investimeve, bima goji është kultivuar dhe përpunuar në mënyrën më të shëndetshme nga kompania "Agrolliria" me plantacione në zonën e Myzeqesë, për të sjellë në treg lëngun "Goji Berry".

Një lëng i freskët, i cili nuk i humbet vlerat e bimës, përmbanë vitaminën C, B2, A, hekur, selenium dhe antioksidantë të tjerë. Kompania synon eksportin e këtij lëngu. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Agrolliria Group: info@agrolliriagroup.com ose në 0692052616.



zgjdh të vendit

Vera "Serina Rosé"

Vera "Serina Rosé" prodhohet nga përzgjedhja e rrushit autokton Serina i cili kultivohet në një klimë të freskët dhe shfaq cilësi të dallueshme të varietetit.

Metoda e veçantë e prodhimit dhe procesit të fermentimit me lëkurën e rrushit për një kohë të shkurtër, sjell këtë verë me ngjyrë rozë të lehtë dhe aromë tipike frutash.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Kantina Nurellari: fatosnurellari@yahoo.com ose në 069 76 94 770.



Qëndistari Zyberaj

Veshjet tradicionale janë element të rëndësishëm që identifikojnë edhe kulturat nga njëra-tjetra. Qëndistari Zyberaj, e pozicionuar në veri të Shqipërisë, ka mbledhur së bashku artizanet e Vau Dejës-it për të sjell produktet dhe veshjet tradicionale, por gjithashtu për të mbajtur gjallë një kulturë aq të vjetër sa territoret e këtij vendi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në Qëndistari Zyberaj: qendistari.zyberaj@hotmail.com ose në 0692804582.



Verë "Taushani"

Vreshtat "Taushani" të vendosur që prej vitit 2004 në një nga zonat më të spikatura dhe me traditë në prodhimin e verës, në fshatin Panaja, ofrojnë varietete, si: Shesh i Zi, Kabëmet dhe Sangiovez. Kjo zonë me një klimë të theksuar mesdhetare, në ndërrturje e detit, lagunës dhe kodrave përreth ofron verë të një cilësie të lartë. Duke ruajtur traditën e përpunimit në kushte primitive, prodhohet një verë bio me kullim natyral pa filtra.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: adriantaushani@gmail.com ose 069 81 22 091



Tjegulla të pikturuara

Riciklimi është një nga format më të bukura të ripërtëntjes së artit. Tjegullat prej argjile pikturohen me peizazhe natyre që duken si të zhytura në komizë.

Stela, në studion e saj në Shkodër, arrin të realizojë piktura të larmishme, duke e kthyer në diçka të veçantë artin e saj. Tjegullat e pikturuara me shumë talent mund të vendosen si dekor në ambiente të ndryshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: stela.toska81@gmail.com ose 067 52 67 450



Gjalpë Arre

E keni provuar ndonjëherë gjalpën e arrës? Ky produkt 100% vendas, vjen në një paketim 200 gram nga kompania "Pemla".

Ky gjalpë ka vlerat më të larta të Omega 3 nga të gjithë arrorët, ka sasi të larta antioksidantësh si vitamina E dhe përbërës të tjerë bimorë që quhen polifenolë. Ndhmon në uljen e rrezikut nga sëmundjet e zemrës.

Zgjidh tënden, kontakto me kompaninë Pemla në: email: info@pemla.al ose në numrin e telefonit: 0692925333.

AIDA ORGANIZOI FORUMIN E DISKUTIMIT "AKSESI NË FINANCË"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave organizoi forumin e diskutimit mbi politikat e aksesit në financë dhe rolit që kanë për mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare.

Pjesë e këtij forumi ishin Ministrija e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj; Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano; Drejtore e AZHBR, znj. Frida Krifca; Përfaqësues i Përhershëm i BERZH për Shqipërinë, z. Matteo Colangeli, si edhe përfaqësues nga sipërmarrjet shqiptare, institucione financiare dhe donatorë të huaj.



Qëllimi kryesor ishte hapja e diskutimeve me përfaqësues të sektorit privat të bizneseve dhe sektorit financiar për qasje të reja në financë në mbështetje të biznesit dhe promovimit të produkteve vendase.

Fjalën e hapjes e mbajti Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s z. Sokol Nano, i cili theksoi asistencën që AIDA ofron për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, (NVM) nëpërmjet informacionit dhe ndihmës teknike, apo partneritetit në thirrje të ndryshme, si edhe nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare me grante publike për NVM-të.



Gjithashtu, z. Nano u shpreh mbi rëndësinë e krijimit të një bashkëpunimi dhe sinergjie të plotë midis institucioneve që i vijnë në ndihmë biznesit të vogël dhe të mesëm.

Gjatë forumit u zhvillua edhe një sesion i hapur pyetje-përgjigje ndërmjet pjesëmarrësve të bizneseve, përfaqësuesve të panelit dhe institucioneve financiare ku u diskutua mbi politikat e aksesit në financë dhe mbështetjen e bizneseve shqiptare.

KONFERENCË - FORCIMI I MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE SHQIPËRI - FRANCË

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Këshilli i Biznesit Francë-Shqipëri morën pjesë në konferencën e organizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe forcimit të marrëdhënieve ekonomike midis Shqipërisë dhe Francës.

Ky takim u organizua nga MEDEF, (Mouvement des Entreprises de France) me ndihmën e ambasadës sonë në Paris dhe ambasadës franceze në Shqipëri.


Të pranishëm ishin përfaqësues nga Ministria e Rindërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano, bëri një prezantim mbi klimën pozitive të investimeve në Shqipëri, sektorëve strategjikë dhe incentivave që shteti shqiptar ofron për inves-

Z. Nano vlerësoi bashkëpunimin mes shteteve, si edhe mundësitë tregtare dhe investimet dypalëshe.

Franca është prezente në disa sektorë, në Shqipëri dhe trendi i investimeve në sektorë të rëndësishëm strategjikë është në rritje.


Takimi u mbyll me synimin dhe objektivin e përbashkët për të vazhduar dhe rritur më tej bashkëpunimin ekonomik e tregtar mes Shqipërisë dhe Francës.



KONFERENCË - SHKËMBIMI I EKSPERIENCËS MES AIDA-S DHE ZYRËS SË INVESTIMEVE TË PRESIDENCËS SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) dhe Zyra e Investimeve e Presidencës së Republikës së Turqisë zhvilluan takim online në kuadër të Programit të Shkëmbimit të Eksperiencave mes dy palëve.

Në këtë videokonferencë përpos stafit të Drejtorisë së Investimeve nga AIDA dhe Zyrës së Investimeve të Presidencës së Republikës së Turqisë mori pjesë edhe agjencia turke TİKA.



Përfaqësues të Drejtorisë së Investimeve të AIDA-s mbajtën një prezantimbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të agjencisë, duke shprehur interesin për thellim të raporteve dhe shkëmbimit të eksperiencave mes dy agjencive.

Strategic Location to manufacture, export and manage...

PROXIMITY TO MAJOR MARKETS
1.3 billion people and \$28T GDP in Europe, MENA and Central Asia at 4 hour flight-distance

CONNECTIVITY
Turkish Airlines connects you to 323 destinations in 127 countries

MANUFACTURING & EXPORT HUB FOR MULTINATIONALS

- TOYOTA** Exporting 85% of its production
- Ford** Exporting 77% of its production
- NISSAN** Production base for MENA
- BOSS** Its largest production facility worldwide

AS WELL AS MANAGEMENT HUB FOR MULTINATIONALS

- B/S/H/** 89 countries
- GE Healthcare** 60 countries
- Lenovo** 83 countries
- Philips** 72 countries
- Intel** 57 countries
- POWERCHINA** 63 countries
- Verifone** 60 countries
- SPK** 30 countries
- Hitsachi Healthcare** 25 countries

16 TIME ZONES

Në kuadër të këtij takimi, pritet të nënshkruhet dhe një memorandum mirëkuptimi që do të shërbëjë si një mundësi dhe urë komunikimi mes AIDA-s dhe Zyrës së Investimeve të Presidencës së Republikës së Turqisë për shkëmbim të përvojave, por dhe këshillim për projekte me interes të përbashkët për të dyja palët.

TAKIME DHE VIZITA



SHKODËR – TAKIME “DOOR TO DOOR” ME KOMPANITË MADISH, AN&GES, MELKANS, RUDAJ PLAST

Stafi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) dhe Enterprise Europe Network-Albania, (EEN-Albania) zhvilluan në qytetin e Shkodrës vizita “Door to Door” në kompanitë: Madish, AN&GES, Melkans, Rudaj Plast.

Vizitat u realizuan në kuadër të monitorimit të fondeve që kompanitë kanë përfituar nga AIDA.

Qëllimi kryesor i këtyre takimeve ishte prezantimi dhe informimi i mëtejshëm mbi shërbimet EEN-Albania dhe mundësitë që ky Rrjet ofron për kompanitë shqiptare.



Katër kompanitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Shkodrës janë të specializuara, në:

- “Madish” me aktivitet fason është e specializuar në prodhimin e veshjeve të brendshme dhe uniformave;
- “Melkans” operuese në sektorin e prodhimit dhe tregtimit të konfeksioneve dhe tekstilit;
- “AN & Ges” me aktivitet në prodhimin dhe tregtimin e konfeksioneve dhe tekstilit;
- “Rudaj-Plast” me aktivitet në fushën e prodhimit dhe tregtimit të dymëve e dritareve prej alumini.

Prodhimet e këtyre sipërmarrjeve eksportohen sot në tregje evropiane duke sjellë si rezultat zhvillimin ekonomik të vendit në termat e punësimit, por edhe duke bërë një prezantim të Shqipërisë dhe potencialeve të saj në tregjet ndërkombëtare.



AIDA, nëpërmjet skemave të financimit, asistencës dhe shërbimeve të “Rrjetit EEN” do të vazhdojë të mbështesë sipërmarrjet shqiptare në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve, nxitjen e teknologjive dhe inovacionit, identifikimin e tregjeve të reja ndërkombëtare dhe zhvillimin e mëtejshëm të produkteve ‘Made in Albania’.

SHKODËR - VIZITA “DOOR TO DOOR” NË AMBIENTET E BIZNESIT TË HYSNI BRAHIMIT & FABJOLA MARKUT

Në kuadër të monitorimit të fondeve, si edhe prezantimit dhe informimit mbi shërbimet EEN Albania, AIDA zhvilloi takime “Door to Door” në ambientet e biznesit të Hysni Brahimit dhe Fabjola Markut në qytetin e Shkodrës.

Hysni Brahimiqë prej vitit 2003 i nisur si një biznes familjar, prodhon nënprodukte të bulmetit, të cilat tregtohen sot në treg dhe marketet në Shqipëri dhe Kosovë nën markën “Hysa”.



Ndërsa, Fabjola Marku me përkushtimin e një biznesi të ri, që prej vitit 2018 merret me prodhimin e ëmbëlsirave në pastiçerinë ku është e vetëpunësuar.

Falë mbështetjes nga fondet e AIDA-s dhe përdorimit të teknologjive të reja, dy bizneset kanë rritur standardet dhe cilësinë e prodhimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre.

AIDA do të vazhdojë të jetë pranë biznesit për të kuptuar më mirë problematikat dhe sfidat, si edhe për të ofruar mbështetje dhe suport për zhvillimin e sipërmarrjeve.



WEBINARE



WEBINAR - “PERFORM & TRANSFORM” PËR INDUSTRIJË AUTOMOTIVE GJATË PANDEMISË COVID-19

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në webinarin me temë: “*Perform & Transform: Strategy for Automotive Suppliers in Times of the Coronavirus Pandemic and Beyond*” të zhvilluar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, (BERZH) së bashku me Horváth & Partners Management. Në webinar morën pjesë edhe përfaqësues nga biznese operuese të sektorit automotiv në vendin tonë.

Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë webinarit lidhen me situatën dhe sfidat aktuale për furnitorët në industrinë automotive dhe disa nga aspektet strategjike të rëndësishme që duhet të optimizohen, si: optimizimi strategjik i portofolit, rimendimi i organizatës, konkurrenca globale e kostove, sipërmarrje digjitale, inovacioni i tregut të shpejtë.



Gjithashtu, përfaqësues nga BERZH shprehën pikëpamjet e tyre mbi situatën e sektorit automotiv në Shqipëri, duke theksuar se vendi ynë ka potencial dhe mundësi të ngjashme me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë periudhë për të gjithë kompanitë e këtij sektori është e rëndësishme që të gjejnë mënyra për të reduktuar kostot nëpërmjet optimizimit dhe eficientës së prodhimit.

Shqipëria ka epërsi në këta dy faktorë, që do të ndikojnë në zhvillimin e këtij sektori në vazhdim.

Nga takimet e vazhdueshme që AIDA zhvillon me biznesin e këtij sektori ka reflektuar se kostot e ulëta, por dhe eficienta apo produktiviteti i forcës punëtore është në përmirësim të vazhdueshëm.

MUNDËSI TË REJA INVESTIMI NË SHQIPËRI KRIPTOVALUTA, BLOCKCHAIN DHE TREGJET FINANCIARE

Zyra ligjore “Tonucci & Partners” me mbështetjen e Confindustria Albania organizuan webinarin me titull “Mundësi të reja investimi në Shqipëri: Kriptoaluta, Blockchain dhe tregjet financiare në dritën e Aktit Fintoken”.

Ky webinar kishte në fokus çështje të ndryshme të lidhura me ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, i njohur ndryshe dhe si Fintoken Act.

Ky ligj ka si objekt rregullimin e emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale; licencimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shpërndarjes, tregtimit dhe ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, e agjentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbimeve inovative dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.

Shqipëria është një nga vendet e para në Evropë që ka hedhur këtë hap dhe ky ligj pritet të jetë një burim i ri për tërheqjen e bizneseve inovative dhe krijimit të mundësive të reja të investimeve.

Zhvillimi më tej i këtij sektori do të krijojë vende të reja pune, të cilat do ta bëjnë vendin më tërheqës dhe do të jenë një shtysë që të rinjtë, por jo vetëm, të qëndrojnë në vendin e tyre.



AIDA PJESË E TRAJNIMIT “MOVING FORWARD IN THE COVID PERIOD”

Grupi përfaqësues i Bankës Botërore organizoi trajnimin "Moving Forward in the COVID Period" në kuadër të programit për promovimin e investimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Investimeve pranë AIDA-s dhe përfaqësues të njësisë vendore, të cilët janë partnerë të rëndësishëm të AIDA-s.

Trajnimi përkoi me prezantimin e rezultateve të bashkëpunimit të suksesshëm për projektet aktuale midis AIDA-s dhe Bankës Botërore, si dhe hedhjen e bazave për të vazhduar bashkëpunimin në të ardhmen.



U diskutuan trendet e investimeve në periudhën e pazakontë të pandemisë dhe sektorët ku do të përqendrohen në vitet e ardhshme, nisur dhe nga mënyra me të cilën pandemia po strukturon ekonominë globale.

Gjithashtu, pjesëmarrësit theksuan vlerën që bart shërbimi “Aftercare” ofruar nga AIDA, si mekanizëm kyç i ruajtjes së investimeve përballë sfidave të kohës dhe idetë kreative që mund të nxisin rriinvestimet.

Trajnimi u mbyll me synimin për të vazhduar edhe më tej bashkëpunimin, tanimë të konsoliduar mes dy palëve.

AIDA NË MBËSHTETJE TË START-UP



CEREMONIA E NDARJES SË ÇMIMEVE “IDEA CHALLENGE 2020”

Projekti IDEA organizoi “Ceremony of regional Winners of IDEA Challenge 2020”, një nismë që ofron mundësi unike për mbështetjen e bizneseve dhe sipërmarrjeve të reja, duke ndikuar në rritjen e aftësive për të bërë biznes dhe për të zhvilluar gjenerimin e ideve novatore dhe planeve të biznesit.

U zhvillua në Korçë ceremonia me gjysmë finalistët nga rajonet e Beratit, Korçës, Vlorës, të cilët prezantuan idetë e tyre të biznesit përpara një jurie profesioniste dhe të pavarur.

E ftuar për të qenë pjesë e jurisë si përfaqësuese e AIDA-s ishte znj. Dildirus Vrioni, Drejtore e Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë.

Në Tiranë kjo ceremoni u zhvillua me gjysmë finalistët nga rajonet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, të cilët po ashtu prezantuan idetë e tyre të biznesit për jurinë.

I ftuar në këtë aktivitet ishte edhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano, i cili përgëzoi dhe mbështeti këtë nismë dhe mundësitë unike që ofron për sipërmarrjet e reja në Shqipëri.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, si një nga partnerët e rëndësishëm të projektit IDEA, nxiti dhe përkrah nisma dhe mundësitë të tilla unike që ofrohen për sipërmarrjet e reja dhe inovative.



KRIJIMI I DHOMËS EKONOMIKE TË GRUAS NË SHQIPËRI

Themelimi i Dhomës Ekonomike të Gruas është një nismë e ndërmarrë për t’iu përgjigjur nevojave të grave sipërmarrëse në Shqipëri, të cilat sipas studimeve del se kanë akses të ulët në financa dhe hasi ende vështirësi në vendimmarrje. Dhoma synon të përfaqësojë zërin e grave sipërmarrëse duke sjellë opinionet, shqetësimet, sfidat dhe vështirësitë me të cilat ato përballen. Nga ana tjetër, nëpërmjet arritjeve dhe historive të suksesit synon motivimin e mëtijshëm të grave.

Me moton “Një grua më e fortë në ekonomi sjell prosperitet për familjen dhe shoqërinë”, Dhoma ka prioritet mbrojtjen e interesave ekonomike dhe sociale të grave sipërmarrëse, profesioniste dhe të vetëpunësuar nga të gjitha sektorët e ekonomisë; ofrimin e shërbimeve promovuese dhe zhvilluese me trajnim dhe mentorim; bashkëpunime kombëtare dhe rajonale; ngritjen e një rrjeti të grave sipërmarrëse; si dhe informim dhe mbështetje me projekte dhe konsulenca.

AIDA si pjesëmarrëse në eventin e hapjes mbështeti këtë nismë të rëndësishme për ekonominë dhe zhvillimin e vendit, si dhe ftoi të gjitha gratë sipërmarrëse në Shqipëri të bëhen pjesë e Dhomës Ekonomike të Gruas për të ndikuar në zhvillimin e njëra-tjetrës.

RUBRIKA | WEBSITE

PLATFORMA “BUSINESS TO BUSINESS”

Në web faqen e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është e publikuar platforma “Business to Business”, (B2B) që ju vjen në ndihmë NVM që veprojnë në Shqipëri.

B2B është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve.

Kjo platformë është një “mekanizëm” lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit.

AIDA, ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B, duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

Për t'u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

PLATFORMA BUSINESS TO BUSINESS

BËHU PJESË!
REGJISTRO BIZNESIN TËND

Na kontaktoni në e-mail: info@aida.gov.al

www.aida.gov.al

AIDA
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

invest in Albania


RUBRIKA COVID-19

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) si pasojë e situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve vazhdon të përditësojë me informacionet më të fundit rubrikën “COVID-19”.

Në të publikohen iniciativat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për të përballuar situatën, informacionet më të reja në lidhje me paketat financiare në ndihmë të biznesit, aplikimet për programet e mbështetjes së biznesit, projektet, nismat e tjera publike, si edhe lidhje e kontakte të rëndësishme.

Rubrika ka si qëllim aksesin dhe qarkullimin e informacioneve më të rëndësishme, në një kohë sa më të shpejtë, për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u njohur me publikimet më të fundit në këtë rubrikë vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/covid-19/>



COVID-19



PËRDITËSIME DHE INFORMACIONE

KALENDARI I THIRRJEVE PËR PROJEKTE WEBINARE DHE TRAJNIME ONLINE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) ka rifreskuar kalendarin e webinarëve, trajnimeve online dhe thirrjeve për projekte për të gjithë sipërmarrësit. Kjo listë shërben për t'i mbajtur sipërmarrësit të informuar për mundësitë e tyre dhe praktikatat më të mira që mund të ndjekin për zhvillimin e biznesit.

Për të ndjekur webinarët dhe thirrjet e ardhshme vizitoni faqen zyrtare në internet të AIDA-s duke klikuar linkun: <http://aida.gov.al/.../Webinare%20trajnime%20dhe...>

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) do të vazhdojë të identifikojë, mbështesë dhe informojë të gjithë sipërmarrësit mbi mundësi të reja për të përkrahur rritjen dhe zgjerimin e biznesit.



VENDIMI PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME NË SEKTORIN E PRODHIMIT

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) ju njeh me vendimin për dhënie të ndihmës financiare për ndërmarrjet e kategorizuara të vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit, në bazë të VKM nr. 856, datë 04.11.2020.

AIDA ka rifreskuar edhe listën me studime dhe raporte ku do të gjeni informacione të përditësuara, të cilat ju dedikohen dhe janë për dijeni të të gjitha bizneseve dhe palëve të interesuara për t'u njohur me zhvillimet më të fundit, në kuadër të veprimtarisë së tyre.

Për më shumë informacion mbi ndihmën financiare për ndërmarrjet e kategorizuara të vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/.../PER-NDIHMEN-FINANCIARE-TE-DISA...>

Për t'u njohur me listën e studimeve dhe raporteve vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/covid-19/>



PROGRAMI I MBËSHTETJES SË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar, (AASF-Albania Agribusiness Support Facility) është një instrument inovativ i zhvilluar nga BERZH në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare.

Ky program motivon institucionet financiare të financojnë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit nëpërmjet programeve të financimit dhe asistencës teknike.

AASF siguron qasje në financimin e sektorit të agrobiznesit tek Institucionet Financiare Partnere në dy mënyra: linja kredie dhe skema garancie mbi shpërndarjen e riskut të portofolit.

Institucionet Financiare japin kredi për bizneset nëpërmjet produkteve afatmesme deri në afatgjata.

Institucionet Financiare Partnere të AASF janë:

- Banka Intesa San Paolo;
- Banka OTP;
- Banka Raiffeisen;
- Banka Pro Credit;
- Fondi Besa.



Nga ky program mund të përfitojnë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në bujqësinë primare, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, përpunuesit e produkteve bujqësore, etj.

Programi i BERZH Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB) ofron më shumë se thjesht financim. ASB ofron gjithashtu këshilla biznesi për bizneset e vogla dhe të mesme, nëpërmjet një ekipi të dedikuar "The SME Finance and Development Group". Projektet e ASB u përshtaten nevojave të SME-ve duke u ofruar zgjidhje reale për biznesin nga ekspertiza e dedikuar/unike në përshtatje me nevojat. Projektet financohen me ndarje kostosh me klientin, për të garantuar angazhimin e plotë të tyre në zbatim. Subjektet kanë mundësi të bashkëpunojnë me një rrjet prej 200+ konsulentësh lokalë dhe 1500+ ekspertësh ndërkombëtarë.

THIRRJE GRANTESH

AIDA njoftoi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shqiptare, si dhe organizatat jo fitimprurëse, ekspertët e lirë, shoqatat e biznesit apo dhomat e tregtisë, se Bashkimi Europian ka shpallur disa thirrje grantesh për aplikim me projekt propozime.

Thirrjet së bashku me detajet e aplikimit dhe linkun për kriteret specifike, gjenden në linkun në vijim:

<http://aida.gov.al/.../2020/12/Njoftim-per-thirrjet.pdf>

INVESTIMET STRATEGJIKE



DBS GROUP

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme kompani të ndryshme për t'i integruar në tregun vendas dhe me gjerë.

DBS Group është një ndër kompanitë që AIDA ka suportuar në këtë aspekt.

Kjo kompani me kapital tërësisht italian dhe e bazuar në teknologjinë më të avancuar është e specializuar në përpunimin e tekstileve elastike për botën e sportit.

AIDA nëpërmjet shërbimit "After Care" e ka ndihmuar kompaninë në lehtësimin e procedurave, duke kontribuar në rritjen e shpejtë të investimit.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE
DBS GROUP
SEKTORI MANIFAKTURË

620
PUNONJËS

AIDA E ASISTUAR NGA AIDA:

- ✓ Për të tejkaluar vështirësitë
- ✓ Për të kursyer kohën dhe kostot
- ✓ Për rekrutimin e stafit
- ✓ Për furnizimin me energji elektrike
- ✓ Për menaxhimin më të mirë të taksave

SEWS-CABIND ALBANIA

Sews-Cabind Albania shpk është filiali shqiptar i kompanisë japoneze SUMITOMO.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka komunikuar me kompaninë prej vitit 2017, kohë kur ka nisur dhe interesi i kompanisë për të investuar në Shqipëri.

AIDA në korrespondencë të ngushtë me Ambasadën e Japonisë në Shqipëri ka organizuar disa takime zyrtare për përfaqësuesit e lartë të kompanisë.

Duke patur një përfshirje strategjike që në fillimet e këtij investimi, krahas ekspertizës së dedikuar, AIDA ka mundësuar ndërlikime me kompani të tjera të sektorit të manufakturës, duke ndjekur hap pas hapi realizimin e planit të biznesit.

Në këtë mënyrë ka bërë të mundur realizimin e investimit në një kohë të arsyeshme dhe integrimin e shpejtë të kompanisë në tregun shqiptar.

INNOVAWAY ALBANIA

"Innovaway Albania" u hap në maj të vitit 2015. Co-business i kompanisë është Help desk, IT si dhe zhvillim i software-it.

AIDA ka qenë kontakti i parë për "Innovaway", duke shërbyer si urë lidhëse mes kompanisë e Qeverisë.

Çelësi i suksesit janë burimet njerëzore në fushën e teknologjisë dhe me gjuhë të huaj. Nga 90 punonjës, 60% janë femra dhe 40% janë meshkuj.

"Innovaway Albania" synon të futet në tregun shqiptar për sa i përket projekteve. Qëllimi i saj është të renditet si një ndër kompanitë më të mira në treg që do të punojë dhe në tregun lokal.



SHFLETO BROSHURAT E REJA TË AIDA-S

BOTIME



INVEST IN ALBANIA 2020

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) publikon versionin e përditësuar të broshurës “Invest in Albania 2020” të cilën mund ta shfletoni në linkun:

<http://aida.gov.al/invest-in-albania-2020/>

Botimi është një përmbledhje e përditësuar me fakte, të dhëna, shifra, të cilat janë pasqyruar në tabela e grafikë, për:

- 5 arsyet kryesore pse të investosh në vendin tonë
- Rritje të eksportit dhe IHD-ve
- Aksesueshmëria
- Profili i AIDA-s
- Incentivat strategjike të investimit: energjia dhe minierat | transporti, telekomunikacioni, infrastruktura dhe mbetjet urbane | turizmi | bujqësia dhe peshkimi | Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) | zo-



ALBANIA CALLS A COUNTRY OF OPPORTUNITIES 2020


Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) publikon versionin e përditësuar të broshurës “Albania Calls-a country of opportunities 2020” të cilën mund ta shfletoni në linkun:

<http://aida.gov.al/albania-calls-a-country-of-opportunities-2020/>

Botimi përmban informacione të përditësuar mbi arsyet kryesore për të investuar në Shqipëri, klimën e biznesit, marrëveshjet e tregtisë së lirë, baza ligjore për investimet e huaja dhe indikatorët makroekonomik.

Incentivat për sektorët kryesorë të investimit, si: udhëtimi e turizmi, manufaktura, bujqësia, transporti dhe logjistika, shërbimet BPO dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA).

Broshura sjell pamje nga atraksione të ndryshme turistike të Shqipërisë.



BRING YOUR BUSINESS TO ALBANIA 2020

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, AIDA publikon versionin e përditësuar të broshurës “Bring Your Business to Albania 2020” të cilën mund ta shfletoni në linkun:

<http://aida.gov.al/bring-your-business-in-albania-2020/>

Broshura përmban informacione mbi arsyet pse të investosh në Shqipëri, ligjin mbi investimet strategjike dhe investimet e huaja, skema 1 Euro si edhe incentivat për sektorët potencial, si: energjia, turizmi, agroturizimi, manufaktura, bujqësia dhe për Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA).



FACTSHEET: SEKTORI I TURIZMIT

Shfletoni online broshurën “FactSheet: Sektori i Turizmit” duke klikuar linkun:

<http://aida.gov.al/sektori-i-turizimit/>

Në këtë botim do të gjeni pasqyrën e Sektorit të Turizmit në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



FACTSHEET: SEKTORI I AGRIKULTURËS, AGROTURIZIMIT DHE AKUAKULTURËS

Shfletoni online broshurën “FactSheet: Sektori i Agrikulturës, Agroturizimit dhe Akuakulturës” duke klikuar linkun:

<http://aida.gov.al/sektori-i-agrikultures-agroturizimit-dhe-akuakultures/>

Në këtë botim do të gjeni pasqyrën e Sektorit të Agrikulturës dhe nënsektorët e tij në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.






FACTSHEET: SEKTORI I ICT DHE BPO

Shfletoni online broshurën “FactSheet: Sektori i ICT dhe BPO” duke klikuar linkun: <http://aida.gov.al/sektori-ict-dhe-bpo/>

Në këtë botim do të gjeni pasqyrën e Sektorit të ICT dhe BPO në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



FACTSHEET: SEKTORI I ENERGJISË

Shfletoni online broshurën “FactSheet: Sektori i Energjisë” duke klikuar linkun: <http://aida.gov.al/sektori-i-energjisë/>

Në këtë botim do të gjeni pasqyrën e Sektorit të Energjisë dhe nënsektorët e tij në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



FACTSHEET: SEKTORI I MANIFAKTURËS

Shfletoni online broshurën “FactSheet: Sektori i Manufakturës” duke klikuar linkun: <http://aida.gov.al/sektori-i-manifakture/>

Në këtë botim do të gjeni pasqyrën e Sektorit të Manufakturës në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



ANKETIM

IDENTIFIKIMI DHE ANALIZA E NEVOJAVE PËR TRAJNIME TË SIPËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME | SITUATA POST COVID

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) për të qenë sa më pranë nevojave të sipërmarrjeve ka hartuar një anketë për identifikimin dhe analizën e nevojave për trajnime të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare (NVM).

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte vlerësimi i gjendjes aktuale lidhur me kapacitetet e burimeve njerëzore në NVM, identifikimi i nevojave për trajnime, për të punësuarit në NVM-të në Shqipëri dhe më pas, në bashkëpunim me institucionet e tjera, krijimin e mundësive për ofrimin e trajnimeve nëpërmjet një platforme pa pagesë.

Rezultatet e këtij hulumtimi do t'i shërbejnë AIDA-s dhe institucioneve të tjera relevante, për ndërtimin e politikave mbështetëse për NVM-të, si dhe në zhvillimin e programeve dhe projekteve në funksion të lehtësimit të qasjes në trajnime adekuate, në formë online, në fushat e nevojshme për të punësuarit në NVM-të në Shqipëri.

Ky hulumtim pasqyron rezultatet nga anketimi i 155 NVM-ve për pikat me theks të veçantë, në:

- Rëndësinë e trajnimeve për ndërmarrjet
- Rritja e aftësive menaxheriale
- Aftësimi dixhital
- Trajnimet për vlerësimin e tregut
- Fushat në të cilat ndërmarrjet kanë nevojë për trajnime
- Gatishmëritë dhe mundësitë e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar trajnimet online



invest in Albania

